



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 30.07.2019, ora 10.00

**Drejton mbledhjen -
Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit**

Rendi i Ditës :

1. Shqyrtimi i rasteve mbi gjetjet e deritanishme në procedurën e verifikimit, për disa prej kandidatëve për vendet vakante Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|---------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 4. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 5. Eriol Roshi | (anëtar) |
| 6. Fatjona Memçaj | (anëtar) |
| 7. Arta Marku | (anëtare) |

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

Shqyrtimi i rasteve mbi gjetjet e deritanishme në procedurën e verifikimit, për disa prej kandidatëve për vendet vakante Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit miratojnë rendin e ditës së programuar.

Këshilli vijon mbledhjen me shqyrtimin e rasteve të kandidatëve të tërhequr nga kandidimet dhe gjetjet për disa kandidatë të tjerë për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese, duke filluar me rastin e parë të kandidaturave të kandidates Valbona Bala.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Arta Marku të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidates Valbona Bala.

Arta Marku, parashtron relatimin për kandidaten Valbona Bala për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe parashtron se kam parë relacionet dhe në lidhje me këtë rast ka pasur gjetje edhe nga ILDKPI. Në këtë rast nuk është se e keni paraqitur në relacion hetimin kryer nga ana e KED-së në lidhje me këtë çështje. Me çfarë dëgjova shkak për të cilin është duke u diskutuar gjetja për ndalimin e kandidimit ka të bëjë me vendimin e KPK-së fillimisht dhe më pas të KPA që ka vendosur ndalimin e kësaj kandidateje për të qenë gjyqtare. Pyetja ime është ky ndalim është vetëm për gjyqtarët, është një ndalim i cili ka ardhur për shkak të shkarkimit nga detyra? Jo. Ka ardhur për shkak të

dorëheqjes së saj dhe zhvillimit në një periudhe të caktuar të punës jo në institucionin përkatës. Edhe ndërprerja nuk ka ardhur për shkak të ndonjë gjetje të tillë që do çonte në shkarkim. Për këtë vjen diskutimi se a do të duhet apo jo dhe në çfarë mase një person të penalizohet për heqjen dorë nga ushtrimi i një detyre apo një funksione në një moment të caktuar kohor. Kandidatja në momentin që ka marrë vendimin e KPK nuk ka qenë më këshilltare në Gjykatën Kushtetuese por punonte në një projekt tjetër.

Ne jemi një organ tjetër kushtetues dhe janë përcaktuar në Kushtetutë shkaqet e ndalimit. Edhe pas vendimit të KPA jemi në një rast specifik. Nuk jemi para rastit të një personi të shkarkuar nga detyra dhe ka marrë këtë lloj penalteti për shkak se ka gjetje të tilla që e bëjnë të pamundur vazhdimin e detyrës së tij brenda sistemit gjyqësor. Kështu që kam mendimin se ky rast është pak i ndryshëm nga rastet e tjera. Gjykoj se nuk jemi përpara rastit të ndalimit dhe nuk duhet të ndalohet në lidhje me këtë çështje. Së dyti edhe vendimi që është dhënë nga KPA nuk e përfshin Gjykatën Kushtetuese. Kjo kandidate paraqitet këtu si gjithë personat e tjerë për të cilët po bëjmë verifikimin nga e para. Nuk do jetë më si gjyqtare, ish gjyqtare etj. por do jetë si një person i cili duhet të verifikohet. Pastaj është tjetër gjë a do konsiderohet kjo si shkak që mund ta ulë në vlerësim. Por në gjykimin tim nuk përbën shkak për ndalimin sepse Gjykata Kushtetuese nuk është pjesë e sistemit gjyqësor dhe së dyti nuk është përcaktuar qartë në përjashtimin e dhënë nga ana e KPA-së. Pra mund të them është çështje morali nëse më pas do vlerësohet apo jo nga KED për tu rankuar. Si do të rankohet është çështje tjetër dhe do të shikohet në performancën e saj të përgjithshme. Duke e lidhur shkakun për të cilin është vendosur ndërprerja e procesit të rivlerësimit nga KPA, duke pasur parasysh faktin që KED-ja po bën verifikim vetë edhe për persona që e kanë kaluar procedurën e vetingun si në rastet e këshilltareve të tjera, qoftë për znj. Arta, qoftë për Fiona Papajorgjin, pra KED-ja nuk e ka marrë të mirëqenë atë procedurë duke e rikryer edhe njëherë procedurën e verifikimit, mendojmë se në rastin konkret nuk kemi shkak ndalimi. Gjitashtu mendoj se KED duhet të gjykojë në thelb në lidhje me verifikimet, të ecim me problematikat që mund të ketë, nëse ka, për sa i përket çështjeve të pasurisë duke qenë se raporti i ILDKPI ka ardhur negativ. Të verifikohet në lidhje me to. Por ky shkak nuk është i mjaftueshëm për të bërë ndalimin e saj nga kandidimi. Nuk duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë personat për të cilat ka gjetje në procedurën e vetingut për papajtueshmëri me detyrën, me personat të cilët për shkaqe tërësisht të tjera nuk ushtrojnë më atë detyrë, qoftë edhe për shkak se ajo punon në një projekt tjetër shumë të vlerësuar. Pra nuk ka pasur të tilla gjetje në figurën morale të kësaj kandidatje apo gjetje për efekt të pasurisë apo për shkaqe të tjera për të cilat edhe është bërë gjithë procedura e vetingut.

Ardian Dvorani relatton rastin tjetër të kandidimit të kandidatës Valbona Bala për vendin vakant, vakancë e parakohshme, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se mbaj të njëjtin qëndrim me rastin e mësipërm dhe do ta paraqes të formuluar edhe me shkrim siç edhe më është kërkuar nga ana e Këshilli. E kisha të pamundur për ta paraqitur sot edhe me shkrim për shkak të kohës dhe afatit tejet të shkurtër për hir të së vërtetës kemi pasur për të verifikuar dhe vlerësuar të gjitha ato dokumente sepse janë me mijëra fletë të cilat duhet ti lexojmë, ti analizojmë dhe ti vlerësojmë. Kam parë vendimmarrje të KPK për raste të tjera për të cilat është ndërprerë procedura e verifikimit dhe është vendosur sanksioni ku janë specifikuar edhe gjykatat, duke u përjashtuar Gjykata Kushtetuese. Mund të shikoni të tëra rastet e ish anëtareve të Gjykatës së Lartë. Aty specifikisht nuk janë të përjashtuar nga Gjykata Kushtetuese. Pra vend për tu gjykuar dhe për tu vlerësuar nga ana e KED-së si një mundësi që nuk përben shkak ndalimi ky vendim i KPA që mund të këtë shkaqe të tjera ndalimi. Mund të këtë shkaqe të tjera ndalimi që mund të lidhen me elemente të tjerë por ky në gjykimin tim nuk përben shkak për ndalimin nga kandidimi në Gjykatën Kushtetuese për sa kohë që nuk e shikoj në asnjë nga ato dy vendime të KPA që kandidatja të këtë bërë ndonjë veprim i cili të mos e lejojë të vazhdojë detyrën e saj. Mendoj se ky lloj sanksioni, në një mënyrë apo një tjetër, është përcaktuar në Kushtetute dhe në ligje të mëtejshme për të mundësuar që ata persona që donin të iknin pa sanksion, të iknin nga sistemi dhe të lehtësonin në një mënyrë apo një tjetër procesin. Kjo ka qenë pritshmëria që njerëzit që kishin probleme me kriteret pasurore apo me kriteret të tjera të largoheshin brenda atij afati tremujor për të lehtësuar në një mënyrë apo një tjetër procedurën e verifikimit. Të themi që në qoftë se largohesh nga detyra pa u mbaruar vetingun do të marrësh gjithsesi sanksion kjo në gjykimin tim është një interpretim i zgjeruar i kësaj dispozitë. Mund të jetë interpretim i gabuar dhe gjykoj se nuk është rasti për të ndaluar personin nga kandidimi në Gjykatën Kushtetuese duke qenë se qartësisht Gjykata Kushtetuese, edhe në ligjet e specifike të sistemit të qeverisjes, nuk është pjesë e pushtetit gjyqësor.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Fatjona Memçaj të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatës Valbona Bala.

Fatjona Memçaj parashtron relatimin për kandidaten Valbona Bala për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi, në datën 04.03.2019.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se kam të njëjtin qëndrim si në rastet më përpara, nuk është e nevojshme ti përsërisim.

Ardian Dvorani i kërkon anëtarit relator Fatri Islamaj të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidates Valbona Bala.

Fatri Islamaj parashtron relatimin për kandidaten Valbona Bala për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 04.03.2019.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se i qëndroj të njëjtave arsyetime.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Vitore Tusha të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidates Valbona Bala.

Vitore Tusha parashtron relatimin për kandidaten Valbona Bala për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi, në datën 12.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se kam të njëjtin qëndrim siç kam pasur lidhur me relacionet tjera lidhur me këtë kandidaturë .

Ardian Dvorani i kërkon anëtarit relator Eriol Roshi të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidates Valbona Bala.

Eriol Roshi parashtron relatimin për kandidaten Valbona Bala për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant vakancë e parakohshme, shpallur nga Presidenti, në datën 07.02.2019.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se kam të njëjtin qëndrim.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Vitore Tusha të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Rexhep Bekteshi.

Vitore Tusha parashtron relativimin për kandidatin Rexhep Bekteshi për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi, në datën 12.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se pavarësisht kërkesës sonë për të pasur së bashku me materialet e dosjes për këtë fazë edhe një listë për dokumentet që na vihen në dispozicion, ne e kemi bërë brenda institucionit inventarin e dosjes së përcjellë për kandidatin Bekteshi. Dosja e këtij kandidati ka ardhur e paplotë. Të vetmet informacione dhe dokumente që kemi e bëjnë të pamundur pasjen e një qëndrimi në lidhje me këtë rast. Të gjitha dokumentet që ne kemi janë ato me kërkesa për informacion nga KED drejtuar ish AIDS, kërkesës për verifikimin nga KPK, kërkesë për informacion për KQZ. Ka edhe një kërkesë drejtuar KLGJ për vlerësimet por për të gjitha nuk janë përgjigjet përkatëse. Kemi kërkesa drejtuar partive politike dhe nga këto ka përgjigje nga vetëm 4 parti. Kemi autorizimin dhe jetëshkrimin e personit. Në total 177 fletë, por jo pikërisht dokumenti dhe qëndrimet e kandidatit në lidhje me gjetjen që është sjellë për shqyrtim. Ato duhet të na vihen në dispozicion që të japim një qëndrim në lidhje me çështjen.

Në parim qëndrimi i Avokatit të Popullit është që persona që kanë probleme me ligjin për të drejtën e informimit me autoritetin e dosjeve janë persona që në përgjithësi nuk duhet të promovohen në pozicione të tilla, aq më tepër pozicione të tilla që mbron të drejtat e njeriut siç është Gjykata Kushtetuese. Pra, për nga natyra ai nuk mund të jetë shkak për të mos vazhduar detyrën e gjyqtarit, nëse ligji nuk e parashikon në mënyrë specifike, por sigurisht përbën një fakt që nuk mund të promovohet në institucione të tilla, të cilat në gjykimin tim duhet të mbrojnë të drejtat e njeriut. Ky është parimisht gjykimi im. Për relacionin nuk ka qëndrim, relacioni ka gjetje që mund të çojnë në ndalim. Është një problem tjetër me relacionet që janë tërësisht pa analizë juridike. Kështu që kjo është gjë tjetër. Ne e kemi paraqitur me shkrim qëndrimin tonë, në lidhje me këtë çështje. Vazhdojmë të mbajmë të njëjtin qëndrim që relacionet janë vetëm një përmbledhje e korrespondencës, pa një arsyetim mbi dokumentacionin që e bëjnë të mangët mundësinë kandidatëve për tu njohur me ato që

janë pro dhe kundër kandidimit. Në rastin konkret unë e kam inventarin e dosjes të këtij personi dhe numrin e fletëve e kam me vetë. Mund tua vë në dispozicion, për tu treguar pikërisht që materialet e dosjes, përveçse nuk kanë ardhur në kohë, përveç kohës së shkurtër që kishim për ti verifikuar, janë tërësisht të pamjaftueshme dhe të pa plota.

Materialet kanë ardhur ditën e premte ndërsa relacioni ditën e shtunë. Nuk mund të shikojmë të gjitha dosjet që janë paraqitur edhe pa e ditur se cilat janë gjetjet. Detyrimi është të na vihet në dispozicion dosja e plotë. Nuk na është vënë në dispozicion në një kohë të mjaftueshme që të japim një qëndrim efektiv, As edhe dokumenti bazë, mbi bazën e të cilit është përgatitur dhe relacioni. Nuk i mënjanohe mi mbajtjes së qëndrimeve. Nëse dokumentet nuk më vihen në dispozicion, me një kohë minimale për ti vlerësuar, sigurisht që qëndrimin e mbajmë vetëm në parim. Nga ana tjetër, kam gjithë të drejtën time të shqetësohem në lidhje me dokumentacionin për të bërë efektivisht detyrën. Kjo është lista çfarë përmban dosja. Dosja ka një inventar dhe ne i kemi me fletë. Se çfarë ju mendoni që keni sjellë duhet që ju duhet të na i kishit sjellë me listë. Ju nuk e bëni listën. Kjo ka qenë kërkesa që ditën e parë që ja u kam kërkuar. Çfarë dokumentesh vihen në dispozicion, që dosja duhet të ketë një listë për dokumentet që përmban, nuk më dukët si ndonjë gjë e jashtë zakonshme. Është një gjë normale që të kemi të qartë se çfarë dokumentesh kemi e për të cilat është bërë vlerësimi apo ku tregohet si është ndjekur apo nuk është ndjekur procedurë. Pastaj, lidhur me qëndrimin që ju keni se mund të flasim vetëm për procedurën, ky është një qëndrim i juaji, unë kam qëndrim tjetër. Unë do të zbatoj ligjin dhe besoj do të zbatoj ligjin drejtpërsëdrejti dhe jo një rregullore. Kjo është një çështje që se si e zbaton ligjin secili. Unë zbatoj një ligj më të lartë sesa një akt më të ulët në hierarkinë e burimeve të së drejtës.

Mbi sqarime të dhëna nga ana e *relatores* dhe pyetjeve për sqarim të drejtuara nga ana e *anëtarëve të Këshillit* lidhur me kohën e marrjes së relacionit dhe të materialeve për këtë kandidaturë, *Erinda Ballanca* parashtron se

Vitore Tusha, në cilësinë e relatores, sqaron se akti i autoritetit që përmban gjetjen si dhe shpjegimet përkatëse të kandidatit mbi to i gjejmë të cituara në mënyrë integrale në përmbajtjen e relacionit, ku citohet edhe koha dhe mënyra e realizimit të korrespondencës me autoritetin dhe kandidatin. Nëse nuk janë në materialet që u janë dërguar, mund tua vëmë në dispozicion, përpara se të shpreheni. Por ato janë cituar ekzaktësisht fjalë për fjalë. Ndërkohë mund të vazhdojmë me rastet e tjera.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe shprehet se jam dakord të marr kohë dhe në përfundim të mbledhjes të shprehem. Por letra duhet të jetë në institucion. Mund të iki si Avokate e Popullit por këto dosje do të ngelen në institucion. Jemi duke vuajtur

jashtëzakonisht shumë pikërisht për këto fakte me kandidaturat e anëtareve të të organeve të vetingut. Na kërkohet informacion i hollësishëm nga individ mbi bazën e ligjit për të drejtën e informimit mbi çdo dokument. Çdo dokument duhet të ndodhet në institucionin e avokatit të popullit. Mbi bazën e atyre dokumenteve ne mbajmë qëndrim dhe duhet të jemi të përgjegjshëm. Prandaj edhe shprehja qëndrimin parimor të institucionit tonë. Pikërisht për të treguar që në parim, institucioni i Avokatit të Popullit, qëndrimin që e ka promovuar edhe vetë në punën që ka kryer, edhe nga avokati mëparshëm. Në të tëra rastet është propozuar se, kur ka pasur qoftë edhe një hetim, është propozuar që të mos jetë në KLGJ, KLP apo edhe në organet e tjera të vetingut, për shkak se ne kemi një standard të lartë të të drejtave të njeriut.

Ardian Dvorani shpjegon se vendimi i autoritetit të dosjeve duhet të jetë në materiale, ndërsa për email me përgjigjen e kandidatit mund të ketë ndodhur të ketë ardhur po në ditën kur është nisur dosja me materialet e rendit të ditës. Për këtë kandidaturë sot është vetëm kjo gjetje dhe nuk trajtojmë gjetjet e tjera. Materialet nuk u dërgohen me listë, sikurse ato në dispozicion të të gjithë anëtarëve, sepse janë materiale të rendit të ditës për mbledhjet dhe mund të mos përmbajnë të gjithë dokumentacionin e dosjes së kandidatit. Ndërsa dosja e dokumentacionit është gjë tjetër. Atë që Avokatit të Popullit ia kërkojnë sot, mundet ti kërkohet edhe KED nesër. Këtu është dhe duhet të jetë i plotë dokumentacioni, i inventarizuar, i regjistruar, ashtu siç mund ti shkojë në kopje organit të emërtesës, sigurisht jo si dokumente pune. Nëse do të ishte mundësia e skanimit të materialit do tu përcillej në rrugë elektronike. Në pamundësi përcillet fizikisht apo me postë. Nuk pa pasur dhe nuk ka asnjë qëllim për të përcjellë dokumentacion të mangët për rendin e ditës.

Ardian Dvorani i kërkon anëtarit relator Eriol Roshi të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit tjetër të kandidatit Rexhep Bekteshi.

Eriol Roshi parashton relatimin për kandidatin Rexhep Bekteshi për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se qëndrimin e kemi po njësoj, si edhe për rastin tjetër. Dosja, në fakt tani e verifikova, ka ardhur në datë 19.07., Ndoshta prandaj ka ndodhur. Por gjithsesi, as letra që ju i keni dërguar kërkesa për shpjegime nuk është dhe as përgjigja. E kam fjalën që dosja është e pjesshme për të dhënë një mendim pikërisht në lidhje me shkakun. Nuk po diskutojmë për të gjithë dosjen në përgjithësi. Ne na

kanë ardhur dokumentet që kanë të bëjmë me atë nëse ka qenë apo jo anëtar i partive politike, dhe pjesërisht çfarë është kërkuar dhe për çfarë përgjigje është marrë. Nuk kemi të gjithë korrespondencën për të parë nëse procedura është bërë e plotë apo jo. Rezervojmë të drejtën që mendimin tonë në lidhje me këtë çështje ta shprehim në momentin kur do të na vihet në dispozicion dokumentet, duke i qëndruar edhe qëndrimit tonë parimor që kemi në lidhje me aplikimin e ligjit për autoritetin e dosjeve për kandidatët që promovohen në pozicione të larta të sistemit të drejtësisë.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Arta Marku të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit tjetër të kandidatit Rexhep Bekteshi.

Arta Marku parashtrohet relatimin për kandidatin Rexhep Bekteshi për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se kam të njëjtin qëndrim si për dy relacionet paraprake.

Ardian Dvorani i kërkon anëtarit relator Fatri Islamaj të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Klodjan Rado.

Fatri Islamaj parashtrohet relatimin për kandidatin Klodjan Rado për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 04.03.2019.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca parashtrohet se ka pyetje për relatorin bazuar pikërisht mbi dokumentet dhe vërtetimet që ka sjellë më pas kandidati e që nuk janë në dosjen që është dërguar. Në dosjen e dërguar ka një mal me dokumente përveç këtyre vërtetimeve dhe kësaj korrespondencës që është bërë për të hetuar në mënyrë më të thelluar përse i përket çështjes së vjetërsisë. A mendoni se sa vite vjetërsi në profesion ka kandidati përderisa në relacion shpreheni ka gjetje që nuk mund të mos i ketë? Në gjykimin tuaj sa vite ka??

Fatri Islamaj, në cilësinë e relatorit, shpjegon se mbledhjen e kaluar kemi bërë edhe një diskutim të kësaj natyre. KED ka vlerësuar se relatorët janë anëtarë të Këshillit dhe kanë detyrimin të marrim vendimin. Në relacion kemi ndjekur këtë metodologji që përgjithësisht përshkruajmë gjetjet, pa u ndaluar dhe pa bërë plotësisht të qartë qëndrimin ose mendimin nëse një kategori e caktuar pune, në optikën time si relator, duhet të njihet apo jo si vjetërsi nga ajo që parashikon neni 7/a i ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Këtë gjë do ta bëjmë gjatë

bisedimit dhe diskutimit të vendimmarrjes. Nuk e kam shprehur në mënyrë të qartë, koncize dhe krejtësisht të lexueshme me qëllim që të mos të biem në kushtet e shfaqjes së mendimit përpara vendimmarrjes, sepse jam pjesë e vendimmarrjes në Këshill. Unë si relator e vlerësoj të rëndësishme që kandidati, Avokati i Popullit të njihen me gjetjet. Kandidatit i janë dërguar disa herë shkresa në raport me gjetjet të cilat potencialisht ose eventualisht mund të konsiderohen të asaj kategorie e natyre që mund çojnë drejt ndalimit të kandidimit për shkak të mos plotësisht të vjetërsisë në punë. Po qëndrimin kategorik, definitiv timin si relator do ta gjeni në vendimmarrje. Kjo është arsyeja pse ne nuk bëjmë të qartë plotësisht analizën e fakteve në raport me ligjin. E kemi përsëritur këtë shpjegim edhe herë të tjera.

Erinda Ballanca parashtrohet se ka pyetje tjetër për relatorin nëse vërtetimi i sjellë nga studio e avokatisë, sepse nuk e kemi kopjen e dokumentit, referon punën e tij si avokat apo si asistent avokat?

Fatjona Memçaj, në cilësinë e relatores për vakancën tjetër po për të njëjtin kandidat, ndërhyr kryesisht për të shpjeguar se është një vërtetim i ardhur nga Ministria e Drejtësisë që e njej atë si asistent avokat, pra të regjistruar pranë Ministrisë si asistent avokat. Ky është i vetmi dokument që disponojmë. Ai është shprehur që nuk disponon një dokument tjetër sepse zoti Haxhi ku ai ka kryer detyrën nuk jeton më dhe nuk ka në dispozicion asnjë dokument tjetër që të provoj se e ka ushtruar efektivisht profesionin në këtë periudhë si asistent avokat pranë zyrës së tij. Shpjegohet se jam paguar për një periudhë me kohë të plotë, për një periudhë tjetër më kohë të pjesshme. As këtë nuk mund ta provoj sepse nuk e di se si zoti Haxhi e ka pasqyruar një fakt të tillë.

Fatri Islamaj, në cilësinë e relatorit, shpjegon se në lidhje më këtë pyetje, mundet të plotësoj diçka. Sigurisht që Këshilli do të mbajë parasysh edhe ato prova që nuk janë paraqitur nga kandidati, duke pasur parasysh që avokati respektiv ku ka ushtruar këtë angazhim kandidati nuk jeton më dhe është e pamundur komunikimi me të. Megjithatë Këshilli do të mbajë parasysh edhe faktin që nuk është paraqitur deri në këtë moment ndonjë dokumentacion nga institucionet shtetërore që janë ISSH dhe Inspektorati i Punës në raport me këtë periudhë. Pra Këshilli do ta ketë parasysh këto fakte dhe gjithashtu edhe shpjegimet e dhëna nga vetë kandidati p.sh përse nuk është paraqitur librezja e punës.

Erinda Ballanca parashtrohet se ka pyetje tjetër për relatorin. Personi e ka bërë ndonjëherë provimin e avokatisë?

Fatjona Memçaj dhe **Margarita Buhali**, në cilësinë e relatores për vendet e tjera vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe ILD, po për të njëjtin kandidat, shpjegojnë se nuk ka një dokument të tillë dhe nuk e pretendon se ka dhënë provimin e avokatisë.

Erinda Ballanca parashtron se ka pyetje tjetër për relatorët se çfarë dokumenti ka paraqitur kandidati, përveç atyre që janë relatuar, për të vërtetuar faktin që ka qenë lektor dhe jo vetëm pedagog, por lektor? Meqenëse nuk i kam vërtetimet e fakultetit tregojnë faktin që ka qenë lektor? Arsyeja është se me gjithë kohën e shkurtër në dispozicion për të shqyrtuar dosjen e kandidatit, këto dokumente nuk ndodhen në atë dosje. Sipas ligji të mëparshëm për arsimin e lartë, në kuptimin tim të parë fjala lektor do të thotë të ishe pedagog i parë. Në fakt ishte e gabuar sepse lektor ishte një titull që merrej pasi kishe marrë ndonjë master dhe kishe kishe ecur në karrierën profesionale. Ndoshta duhet bërë edhe ky dallim. Në kohën përpara se të bënte Shkollën e Magjistraturës, duke qenë se ajo nuk konsiderohej në të kaluarën si master ose të kishte një titull më lartë për të qenë lektor. Apo ndoshta vitet gjatë kohës që ka qenë në Shkollën e Magjistraturës do të konsiderohen apo jo të përfshira në vite, për efekt të kushtit të përcaktuar në ligjin për Gjykatën Kushtetuese për të qenë anëtar i kësaj Gjykate.

Fatjona Memçaj, në cilësinë e relatores për vakancën tjetër për të njëjtin kandidat, sqaron se vërtetimi i parë është një vërtetim i Dekanit të Fakultetit Juridik që sqaron periudhat gjatë të cilës ka ushtruar funksionin pedagog i jashtëm pranë Fakultetit Juridik. Ne e kemi pasur parasysh dhe e kemi diskutuar në Këshill legjislativ mbi arsimin e lartë në Shqipëri që ka ndryshuar gjatë gjithë viteve dhe titullin pedagog i jashtëm.

Margarita Buahli, në cilësinë e relatores për vakancën tjetër për të njëjtin kandidat, sqaron se edhe për kandidaturën e tij për Inspektor i Lartë i Drejtësisë është dërguar një shkresë për ta sqaruar më mirë periudhën e punës sepse shkresa e parë referonte vetëm vitet dhe jo qenien pedagog i jashtëm. Edhe në relatimin e tij zoti Fatri e relatoj me detaje që çfarë është kërkuar, pra nëse kanë kontrata pune apo jo, lëndën konkretë që ka dhënë, periudhën e punës që ka ofruar këtë shërbim. Shkresa ka mbërritur dje nga Fakulteti i Drejtësisë dhe tregon se kandidati është angazhuar si pedagog i jashtëm më kohë të pjesshme pranë departamentit të së drejtës publike, në fakultetin e drejtësisë për vitet akademike 2004 – 2005, 2005 – 2006, 2006 – 2007, 2007 – 2008 semestri i dytë, në lëndën e drejta kushtetuese. Ndërkohë, edhe për vitet 2018 – 2019 semestri i parë, në lëndën e drejta kushtetuese e avancuar, niveli master shkencor me 6 orë semestrale në javë. Bashkëlidhur për vitin 2018 – 2019 ka vendosur kontratën. Për periudhën më përpara këto janë të dhënat që sjell fakulteti.

Erinda Ballanca parashtron se ka pyetje tjetër për relatorët. A ka ndonjë dokument në lidhje me punësimin e tij gjatë viteve që ka jetuar në Kanada, ku pretendon se ka bërë doktoraturën dhe ka qenë i punësuar në fakultet.

Fatjona Memçaj, në cilësinë e relatores për vakancën tjetër për të njëjtin kandidat, sqaron se kandidati ka sjellë vërtetim nga Universiteti i cili pohon faktin që gjatë këtyre

viteve përveç qenies së tij si student i doktoraturës, ka dhënë mësim edhe si lektor. ka kryer edhe funksionin e lektorit të së drejtës për një ndër lëndët dhe ka përcaktuar kohën gjatë të cilës e ka ushtruar këtë detyrë. Ka sjellë edhe vërtetimet e pagesave. Vërtetimet janë në gjuhën angleze që gjithashtu na është vënë në dispozicion, i përkthyer.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se pyetjet i kam të lidhura me faktin e periudhave. Sepse për shembull, në fakultetin e drejtësisë ka qenë midis disa semestrave që do të thotë që nuk i marrim dot si vite të plota. Merren aq muaj sa kanë semestret sepse në momentin që ka paraqitur kërkesën për kandidim, është i vetmi kandidat që e ka jashtëzakonisht shumë të ngushtë vjetërsinë. Ka 15 vjet e 2 muaj duke qenë se ka përfunduar fakultetin në vitin 2003. Duhet të kishte punuar çdo muaj të jetës së tij. Prandaj jam duke pyetur që ky dokument i ardhur Kanadaja referon semestrin, siç ishin për shembull rastet konkrete që ishin të fakultetit tonë juridik që kishte punuar për disa semestre. Pra nuk mund ti quajmë si vite të plota. Në gjykim tim si Avokate e Popullit, ti njihet vjetërsia për ato periudha që ai realisht ka punuar. Ju sigurisht keni vendimmarrjen tuaj. Nuk e dimë sa kredite ka, sa kohëzgjatje ka. Problemi tjetër që unë kam është se ndonëse tregon për ushtrimin e detyrës së gjyqtarit deri në vitin 2015, po ai vërteton që nga viti 2012 ka shkuar në Kanada dhe nuk e ka ushtruar këtë detyrë. Pra, o ka qenë gjyqtar, o ka qenë doktorant. Domethënë janë disa dokumente që realisht duhen parë dhe të trajtohen në mënyrë të hollësishme sepse ka qenë një nga rastet që realisht na ka marrë shumë kohë për të trajtuar këtë, nëse janë apo jo vitet e plota në funksione lektori apo gjyqtari, për rastin e Gjykatës Kushtetuese sepse në funksionin e asistentit apo të juristit për efekt të kësaj Gjykate, në gjykimin e Avokatit të Popullit, nuk i njihen si vite vjetërsie.

Lidhur me qëndrimin për këtë rast kandidimi Avokati i Popullit ka paraqitur një listë me gjithë inventarin e dosjes në të cilin pikërisht dokumentacioni që ka të bëjë me vjetërsinë në punë nuk ndodhet. Është gjithë informacioni financiar me të gjitha kërkesat dhe përgjigjet që janë kthyer nga bankat. Gjenden deklaratat, formulari i vetëdeklarimit, autorizimet dhe qëndrimet e ILDKPI-së. Por korrespondenca dhe dokumentet përkatëse në lidhje me çështjen e vjetërsisë nuk na janë vënë në dispozicion. Megjithatë nga sa është relatuar në lidhje me pozicionin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, Avokati i Popullit gjykon se nuk plotësohet kriteri i viteve të përcaktuar nga ligji për të qenë 15 vjet në pozicione e caktuara si jurist i lartë i administratës shtetërore apo lektor apo gjyqtar, rast pas rasti. Nga ana tjetër, duke jetuar për një periudhë të gjatë në Kanada, nuk kemi informacion mbi gjendjen e tij penale gjatë këtyre viteve që ka jetuar jashtë vendit. Ndoshta duhet të kishte informacion edhe në

lidhje me këtë çështje. Kështu që qëndrimi ynë përfundimtar, është se ka vend për tu ndaluar për shkak të mos plotësimit të kriterit të vjetërsisë në profesion, të paktën në mënyrë të qartë në gjykimin tonë për të dy rastet e kandidimit në Gjykatën Kushtetuese. Kjo duke marrë të dhënat nga relacioni për të mos dashur të shtyjme në kohë apo të pengojmë vendimmarrjen e Këshillit.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Fatjona Memçaj të relatojë gjetjet për rastin tjetër të kandidimit të kandidatit Klodian Rado.

Fatjona Memçaj, parashtron relatimin për kandidatin Klodian Rado për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 04.03.2019.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se mbaj të njëjtin qëndrim si edhe për kandidimin në vakancën e mëparshme, janë të njëjta kushte dhe të njëjtat gjetje. Gjithsesi do ta paraqesim qëndrimin tonë edhe me shkrim, për efekt të paraqitjes së vendimmarrjes. Por do tu kërkoja zoti kryetar, këto informacione dhe këto referenca të na vihen në dispozicion duke qenë se është gjithsesi e pa plotë.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Margarita Buhali të relatojë gjetjet për rastin tjetër të kandidimit të kandidatit Klodian Rado.

Margarita Buhali, parashtron relatimin për kandidatin Klodian Rado për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca parashtron se ka pyetje për relatorin. Pyetja e parë ka të bëjë me faktin a ka ndonjë dokument, a ka pasur një zyrë avokatore profesor doktor Paskal Haxhi. Nëse ka pasur, një person juridik a person fizik, a ka qenë e regjistruar si zyrë avokatore më një kod fiskal ?

Margarita Buhali, në cilësinë e relatores shpjegon se lidhur me këtë moment i jemi referuar vetëm shkresës që ka ardhur nga Ministria e Drejtësisë, duke qenë që kandidati është i regjistruar si asistent në këtë zyrë dhe e kemi marrë të mirëqenë ekzistencën e kësaj zyre. Por ajo që diskutohet është një marrëdhënie punësimi e deklaruar dhe e vërtetuar për periudhën 1 vjeçare.

Erinda Ballanca parashtron pyetjen tjetër. Duke qenë se nuk e kemi evidenca për pretendimin që ka qenë jurist për periudhën tetor 2003 – tetor 2006 pranë shoqatës

“Qytetërim dhe drejtësi”, a ka qenë e regjistruar shoqata? Ka paraqitur ndonjë dokumentacion në lidhje me aktivitetin e saj? Çfarë mund të ketë nevojë një shoqatë për jurist dhe çfarë aktiviteti ka kryer gjatë kësaj periudhe?

Fatjona Memçaj, në cilësinë e relatores së vendit tjetër vakant të shqyrtuar shpjegon se ka paraqitur një vërtetim nga shoqata që tregon se duke qenë anëtar në bordin e tij dhe ka qenë edhe jurist i shoqatës pa pagesë. Është një shoqatë e angazhuar në fushën e së drejtës, pra është shoqatë që merret me problemet e legjislacionit dhe vijon të jetë si shoqatë. Është vërtetim i sjellë nga ana e kryetarit të shoqatës. Pra, vazhdojmë ta theksojmë që është një punësim pa pagesë, thjesht një angazhim profesional vullnetar në dobi të përmirësimit të legjislacionit.

Erinda Ballanca parashtron pyetjen tjetër. Në relacion nuk referohet dhe duke qenë se ndryshojnë pak kriteret e ligjit për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë nga ato të Gjykatës Kushtetuese. Për shkak se sipas nenit 199 kandidati nuk duhet të jetë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve të inteligjencës. Shkresën tuaj për ILD-në ne e kemi dhe është korrekte por nuk e kemi përgjigjen dhe nuk e dimë qëndrimin e shërbimit informativ. Mund të jetë që nuk e tregojmë që është informator. Ky është problem që të mos e thonë sepse kur është negativ atëherë jemi në rregull, ndërsa nëse nuk thonë asgjë domethënë që edhe mund të jenë.

Margarita Buhali, në cilësinë e relatores dhe **Ardian Dvorani** në cilësinë e Kryetarit dhe përfaqësimit të KED në komunikimin shkresor me të tretët, shpjegojnë se tek shkresa drejtuar shërbimeve informative, pastaj DSIK kur iu kërkua ndihmë administrative, janë të përbashkëta të gjitha elementet e tjerë, kurse për ata që ishin kandidat për Inspektor të Lartë të Drejtësisë ka edhe një element plus, a janë agjent të shërbimeve aktualisht. Edhe përgjigja që ka ardhur vjen në bllok e tëra, kështu që ne e prezumojmë të kontrolluar këtë gjë. Nëse mendohet e paqartë mund të kërkohet shpjegim shtesë.

Erinda Ballanca, sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se për çështjen e vjetërsisë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk ka të njëjtin parashikim si për Gjykatën Kushtetuese. Neni 199 referon se duhet të ketë jo me pak se 15 vjet përvojë pune në profesionin si jurist. Kështu që për këtë shkak ndoshta duheshin verifikuar dokumentet një e nga një, për efekt të përvojës së punës në profesion si jurist. Gjithsesi, nuk gjejmë dokumente të mjaftueshme, me ato që kemi në dispozicion, për të justifikuar vjetërsinë. Nga relatimi të paktën ka një mbivendosje midis të qenit jurist pranë zyrës avokatore të zotit Paskal Haxhi, dhe të qenurit jurist tek shoqata. Ka një mbivendosje me shoqatën ku pretendon të jetë nga

tetor 2003: Edhe nëse ka bërë ndonjë punë tjetër, puna e karakterit juridik do të ketë qenë pikërisht për themelimin e shoqatës. Është një punë të cilën e ka bërë gjatë periudhës e cila ishte e konsideruar si një periudhë juristi pranë zyrës avokatore të Doktor Paskal Haxhit. Nga ana tjetër, nëse këto dy periudha do të konsideroheshin si vjetërsi në punë për efekt të përvojës profesionale, mendoj se këto do të ndikonin qartësisht në vlerësimin e pasurisë dhe të pastërtisë të tij . Nëse ai nuk vërtetohet dhe nuk ka asnjë mundësi për të vërtetuar që ka plotësuar detyrimet fiskalë në lidhje me këto vite dhe me këto të ardhura, sigurisht që për këto çështje nuk plotëson kriterin tjetër të verifikimit të të ardhurave nga ana e ILDKPI-së. Prandaj për rastin konkret nuk mundet të përfundoj procesi pa një hetim më të plotë në lidhje me këtë çështje.

Nga ana tjetër, pretendon se ka qenë anëtar i shoqatës dhe ka bërë edhe Shkollën e Magjistraturës, ku për vitin e tretë ka qenë gjyqtar dhe e konsideroj që është përvojë profesionale, por për dy vitet e tjera nuk i konsideroj si vite të plota të përvojës profesionale. Por nëse ka qenë apo jo si jurist apo edhe si pedagog për atë nuk ka vërtetim. I mbetet Këshillit të bëjë një vlerësim të drejtë dhe kandidati duhet ti kishte paraqitur dokumente pune dhe vërtetimin e shoqatës për sa i përket asaj që ka qenë efektivisht puna e tij si jurist pranë kësaj shoqate, aq më tepër që është një punë e papaguar dhe e padeklaruar.

Mendoj që mbetet prapë për tu diskutuar çështja e informacionit në lidhje me deklaratën penale për vitet që ka qenë jashtë shtetit. Gjithashtu mbetet shumë e paqartë dhe i pakuptimtë pretendimi se nuk ka librezë pune. Libreza e punës është një dokument që i përket palës dhe pala mund ta bëjë përsëri librezën e punës. Shkon tek secili punëdhënës, i plotëson vitet rast pas rasti dhe në fakt duhet të kishte pasur një përpjekje nga ana e kandidatit për të plotësuar ato vite pune. Nuk mund të ketë dokument për punën aty ku personi ka vdekur apo nuk ekziston por për vitet e tjera të punës sigurisht do të duhet në gjykim tonë ti kishte në një dokument. Kjo nuk përbën kusht për moskandidim, por sigurisht duhet të marrë në konsideratë në vlerësimin e përgjithshëm.

Këshilli ndërpret diskutimet për një pushim të shkurtër.

PJESA E DYTË E MBLEDHJES

Mbledhja e Këshillit, pas pushimit, vijon me shqyrtimin e gjetjeve në procedurat e verifikimit të disa kandidatëve të tjerë për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese. Fillimisht për gjetjet në kandidimet e zotit Sinan Tafaj, në katër vende vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

Ardian Dvorani relaton rastin e kandidimit të kandidatit Sinan Tafaj për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtrohet se e kam lexuar me shumë vëmendje relacionin edhe për hir të fatit se sigurisht vjen nga një grup që ka një aftësi ndryshe. Për këtë shkak edhe ne si institucion kemi një vëmendje më të veçantë. Nuk do të kishte asgjë të keqe që të kishim një kandidatë i tillë e të ishte pjesë e Gjykatës Kushtetuese e cila të garantonte standarde të larta në zbatim të të drejtave të njeriut. Pavarësisht sa më sipër, duhet të konsideroj disa prej gjetjeve të ILDKPI-së. Nuk më krijon asnjë lloj problemi edhe ti rendis por ajo që mendoj se është problem është fakti i mos deklarimit të të ardhurave. Pra, nuk është çështja e pagesës apo jo e tatimit por mosdeklarimit të të ardhurave të realizuara. Përveç që është një detyrim ligjor, kjo e bën të pamundur verifikimin e të ardhurave realisht janë krijuar në ato vite. Problemi tjetër që mund të shtrohet dhe të trajtohet nga ana e Këshillit është se çfarë pasojë do të kishte fakti i mosdeklarimit për aq kohë sa ai gjithsesi nuk do të paguante tatim. Në vijim të asaj që është bërë deri më tashmë ndaj K.P.K, ka qenë se e ardhura ka qenë e paligjshme nëse nuk është paguar tatim. A përbën mosplotësimi i një rregulli procedural pa pasojë, shkak për të mos u kandiduar, për të mos vazhduar procesin e kandidimit? Kam pikëpyetjet e mia, por gjithsesi mendoj që deklarimi është i pasaktë, ka mungesë burimesh, sigurisht për realizimin e këtyre pasurive dhe mundet të përbëjë shkak për ndalimin e kandidimit. Në disa nga gjetjet e ILDKPI-së, ku thuhet janë çmimet e ulta të kontratës, unë nuk shikoj se për çfarë arsye thuhet që janë të ulta. A duhet të vërtetoj se ka pasur një mjet fiktiv apo ka pasur realisht një problem në lidhje më këtë. Kjo e bën të pamundur nxjerrjen e një konkluzioni deri në këtë pikë.

Çështja tjetër janë deklaratimet për huamarrjet e shumave nga persona të tjerë dhe që ata nuk duken ti kenë këto të ardhura, pavarësisht se mund të kenë një biznes. Në rastin e nipave, njëri është gjinekolog dhe tjetri stomatolog. Mendoj që një pjesë e gjetjeve nuk janë të tilla që mund të ndalojnë kandidimin sidomos ato që kanë të bëjnë me bashkëjetuesin e vajzës ku ai e ka paguar pjesën e vetë të shtëpisë. Me këtë gjendje të dokumenteve nuk mund të dalim me një konkluzion të qartë në lidhje me verifikimin e pasurisë. Nuk e di se çfarë vendimmarrje do të mbaj Këshilli në parim në lidhje me këto gjetje negative. Do të jetë vetë ai që do të vendos mbi bazën e dokumenteve që ka paraqitur kandidati apo do të kërkojë

caktimin e një eksperti. Por mendoj që duhet të mbahet një qëndrim i unifikuar për të tëra rastet.

Lidhur me ndërtimin për tu legalizuar dhe që është shembur, shpjegohet se meqenëse ai nuk ekzistonte më, nuk e rindërtova dhe nuk e rikonstruktova, pra nuk kam shpenzuar para për këtë gjë. Ky është pretendimi i kandidatit por nuk e dimë rrjedhën e fakteve sepse ai ka qenë një send ekzistues. Aty mund të kishte një problem me deklarin e pavërtetë sepse nëse deklaroi që e ka ndërtuar vetë duhet që ai deklarim të qëndrojë, por nëse ai deklaroi që nuk e ka deklaruar vetë, nuk ka pse ta legalizojë.

Për sa i përket çështjes së doktoraturës, pra që kandidati mund të marrë shpërblimin për çështjen e doktoraturës për shkak të parashikimeve ligjore. Jo, parashikimet ligjore i përkasin vetëm sektorit publik, për nëpunësit civil. Megjithatë, meqenëse ajo është një shoqatë një person juridik, mundet që arsyetimi nuk qëndron. Një e drejtë që i njihet punonjësve të cilët janë në sektorin publik nuk do të thotë që kjo e drejtë automatikisht i njihet të gjithë punonjësve që janë në sektorin privat. Por nga ana tjetër, është tjetër çështje nëse sektorit privat ia njeh këtë shpërblim. Diskutimi mund të ishte nëse kjo vendimmarrje është marrë prej tij në kushtet e konfliktit të interesit apo është marrë për organet e shoqatës. Në qoftë se unë them shiko merreni ju vendimin se unë jam në konflikt dhe nuk mund të vendos të marrë vetë një gjë për shkak të ligjit është diskutim tjetër. Shoqatat vërtetë janë persona juridik privat, por nuk janë shoqëri tregtare, ka një lloj dallimi midis dy formave.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatore Vitore Tusha të relatojë gjetjet për rastin tjetër të kandidimit të kandidatit Sinan Tafaj.

Vitore Tusha parashtron relatimin për kandidatin Sinan Tafaj për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi, në datën 12.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se kam të njëtin qëndrim që mbajta dhe në fillim me relacionin që bëtë ju zoti kryetar pasi është e njëjta situatë dhe e njëjta çështje.

Ardian Dvorani i kërkon anëtarit relator Eriol Roshi të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit tjetër të kandidatit Sinan Tafaj.

Eriol Roshi parashtron relatimin për kandidatin Sinan Tafaj për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se mbaj të njëjtin qëndrim që e kam diskutuar në lidhje me relacionin e parë.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Arta Marku të relatojë gjetjet për rastin tjetër të kandidimit të kandidatit Sinan Tafaj.

Arta Marku parashtron relatimin për kandidatin Sinan Tafaj për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti, në datën 07.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se nuk kam asnjë gjë tjetër për të shtuar, përveç qëndrimit që kam mbajtur në lidhje me relacionet e mëparshëm.

Ardian Dvorani i kërkon anëtarit relator Eriol Roshi të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit tjetër të kandidatit Petrit Kaja.

Eriol Roshi parashtron relatimin për kandidatin Petrit Kaja për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca shprehet se relacioni që na është dërguar është pa konkluzion, nuk mban asnjë lloj qëndrimi. A kanë këtë lloj relacioni edhe palët? Sepse në relacionin tjetër për këtë kandidat ka të shkruar që duke qenë se paraprakisht ka gjetje që mund të sillnin ndalimin e kandidimit. Në qoftë se i dërgohet kandidatit do ta ketë të qartë se për çfarë do të diskutohet në mbledhje. Kjo ishte shkak për të cilin unë e ngrita sepse shikoj që njërin nga dokumentet.

Eriol Roshi shpjegon se për këtë janë shprehur dhe kolegët dhe nuk është e nevojshme të shprehemi më. Ne e quajmë të ezauruar këtë, të paktën, ne si Këshill.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe konkludojnë në qëndrimin e mbajtur tashmë se në ato raste kur relatori e sjell çështjen për shqyrtim në Këshill për të tre komponentët e verifikimit nuk ka arsye që të shprehet në relacion nëse ka apo jo gjetje që mund të sjellin ndalimin e kandidimit. Ndërsa në rastet kur relatori e sjell çështjen në Këshill vetëm për njërin komponent atëherë është e kuptueshme vetëvetiu që ka një problem dhe në relacion tregohet se ka gjetje që mund të sjellin ndalimin e kandidimit. Por në të dy rastet, e

rëndësishme është që kandidati është i njohur me problemet që mund të jenë evidentuar gjatë procedurës së verifikimit dhe ka dhënë shpjegimet e tij për ato probleme. Nuk përjashtohet edhe mundësia që relacioni sillet për të tre komponentët dhe nuk ka gjetje paraprake për ndalim kandidimi por ato rezultojnë nga mbledhja e Këshillit dhe në këto raste Këshillit ndërpret shqyrtimin, njofton kandidatin që në një afat të caktuar të japë shpjegimet dhe më pas e rishqyrton çështjen. Në të dy rastet në shqyrtim të kandidatit Petrit Kaja, gjetjet janë të njëjta por mund të jenë shpërndarë në njërin rast një version paraprak i pakonsoliduar. Gjithsesi kandidati Petrit Kaja është në dijeni dhe ka dhënë shpjegime për gjetjet problematike.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se nuk kemi ndonjë koment të veçantë në lidhje me këtë kandidim. Përveç faktit nëse ka pasur ose jo ndonjë shpjegim që kandidati ka mbaruar shkollën e lartë përpara afatit. Nuk trajtohet në relacion dhe ne nuk i kemi dokumentat në lidhje me këtë pikë. Vitet janë 91 – 94, 3 vite. Ndoshta ka qenë i shkëlqyer dhe e ka bërë më shpjegjet, nuk e di.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Arta Marku të relatojë gjetjet për rastin tjetër të kandidimit të kandidatit Sinan Tafaj.

Arta Marku parashtron relatimin për kandidatin Petrit Kaja për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti, në datën 07.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtares nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se kemi të njëjtin qëndrim si për relacionin e parë të bërë nga zoti Roshi. Në fakt në këtë rast ka një qëndrim. Tani ne nuk kemi qëndrim në lidhje me çështjet e gjetjeve të ILDKPI-së, por në lidhje me faktin procedural ka një qëndrim nga ana e znj. Marku në lidhje me këto problematika. Sigurisht në gjykimin tonë ky relacion është më i saktë sepse ne mbajmë qëndrim që duhet bërë një vlerësim nga ana e relatorëve siç edhe e kërkon ligji.

Pati një qëndrim nga Këshilli që nuk duhet të japim asnjë lloj qëndrimi dhe vetëm duhet të tregojmë në relacion disa fakte. Unë këtë e kam quajtur të gabuar dhe do ta quaj të gabuar. Pavarësisht të gjithë gjërave të tjera duhet të ketë një vlerësim nga relatori për çështjen. Në qoftë se relatori nuk ka asnjë vlerësim dhe bën vetëm një renditje të letrave që janë, kjo do të thotë që nuk ka bërë asnjë punë vetë, por e ka bërë këshilltari dhe e ka

nënshkruar vetëm aty poshtë. Mendoj që duhet të ketë vlerësim dhe pa vlerësim nuk i duhet çuar kandidatit.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Margarita Buhali të relatojë gjetjet për rastin tjetër të kandidimit të kandidatit Genci Gjonçaj.

Margarita Buhali, parashtron relatimin për kandidatin Genci Gjonçaj për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Njëkohësisht i shtron Këshillit për diskutim edhe faktin që ka të dhëna dhe gjetje në lidhje me ushtrimin e funksioneve politike që mund të sjellin ndalimin e kandidimit. Gjithsesi janë relatuar të gjitha verifikimet në kuptim të vendimmarrjes së Këshillit për të tre komponentët. Kështu, që Këshilli mund të marrë një vendimarrje të plotë për kandidatin në rast se do të vlerësohet për lejimin apo ndalimin e tij.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Fatri Islamaj pyet relatoren nëse është konsultuar me statutin e subjektit për të cilën është ngritur diskutimi i gjetjes për ushtrimin e funksioneve politike?

Margarita Buhali shpjegon se jam konsultuar me statutin. Edhe vetë kandidati ka dhënë disa shpjegime për sa i përket statutit. Gjithsesi, për që sa më lejohet në këtë fazë, mbi këto të dhëna unë e kam relatuar gjetjen. Nëse ju e vlerësoni printojmë edhe një kopje të statutit dhe ta kemi të gjithë në dispozicion në momentin e vendimmarrjes.

Erinda Ballanca parashtron se ka pyetje. Në fakt relacioni është i plotë dhe i qartë në lidhje me këtë çështje. E kemi verifikuar dhe e kemi parë këtë rast. Në fakt na rezulton sipas dispozitës përkatëse që asambleja kombëtare është organ drejtues i Partisë Socialiste. Lind pyetja nëse pjesëmarrja në asamble përbën apo jo pozicion drejtues drejtpërsëdrejti? Ky është diskutimi. Në momentin e parë, për hir të së vërtetës, unë mendoja se asambleja kombëtare do të ishte si kongresi ku ti merr pjesë një herë në 4 vjet dhe nuk ka funksione të tjera. Është një pjesëmarrje, një organ, i cili përgjithësisht ka si funksion më tepër zgjedhjen e organeve drejtuese sesa kryerjen e detyrave drejtuese funksionale. Duket që Kongresi është nga asambleja kombëtare. Asambleja kombëtare sigurisht ushtron funksione vendimmarrjeje në lidhje me subjektin politik. Unë nuk e kam shumë të qartë dhe nuk e kam përpara nenin e anëtareve “ex officio” të asamblesë kombëtare. Kandidati pretendon se është për shkak të pozicionit të punës, por nuk është anëtar partie. Nga diskutimi i anëtarëve këtu rezulton se tek anëtarët ex officio nuk përmendet përfaqësuesi në kolegjin zgjedhor. Ndërkohë që nëse është apo jo asambleja kombëtare organ drejtues i partisë socialiste kjo është e shkruar qartë në fakt në statutin e tyre dhe nuk ka asnjë mundësi tjetër interpretimi në gjykimin tim. Qartësisht për shkak të kontributeve të tij në asamblenë kombëtare ka qenë në një funksion drejtues të Partisë Socialiste. Ky është qëndrimi i Avokatit të Popullit. Kemi përsëri komentimin edhe për

sa i përket përgjigjes me informacionin nga SHISH. Gjithashtu duke qenë se rezulton për një periudhë të caktuar jashtë shtetit ndoshta do të duhet të kishim një vërtetim penaliteti nga vendi në të cilën ai ka jetuar një periudhë kohe.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Margarita Buhali të relatojë gjetjet për rastin tjetër të kandidimit të kandidatit Artur Metani.

Margarita Buhali, parashtron relatimin për kandidatin Artur Metani për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

Ardian Dvorani pyet anëtares nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca parashtron se ka pyetje. Në relacionin dhe në dokumentet që na kanë ardhur është referuar se ju i jeni drejtuar me një shkresë institucionit të Presidentit të Republikës për të kërkuar qëndrimin dhe interpretimin në lidhje me pozicionin e kandidatit dhe gjithashtu Departamentit të Administratës Publike. Në fakt pyetja ime qëndron se nëse kërkesën që ju keni bërë për sqarimin e pozicionit apo të kuptimit të funksionit politik e keni dërguar vetëm tek Presidenti i Republikës apo edhe tek Departamenti i Administratës Publike? Sepse përgjigja nga Departamenti i Administratës Publike ka ardhur vetëm në lidhje me faktin nëse ka apo jo masa disiplinore. Pra, në gjykimin tim një interpretim në lidhje me këtë çështje më të saktë do ta jepte Departamenti i Administratës Publike në lidhje me çështjet e funksionarëve nga administrata shtetërore, sesa institucioni i Presidentit.

Margarita Buhali shpjegon se shkresa i është dërguar kabinetit të Presidentit si organi i emërtesës ndërsa Departamentit të Administratës Publike vetëm sa i përket masave disiplinore. Gjithsesi do ti verifikojmë të dyja patjetër sepse ishte një periudhë goxha e dukshme dhe ishte momenti i lirimit nga detyra që nuk na dilte e qartë. Prandaj jemi mbështetur tek përgjigja e Presidentit. Por gjithsesi mendoj që kjo është edhe çështje debati ligjor. Pra fakti i kryerjes së kësaj detyre është i provuar. Pastaj nëse duhet të marrë një përgjigje definitive nga Drejtoria e Departamenti i Administratës Publike, këtu jemi mund ta vlerësoj Këshilli.

Erinda Balanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron që, nëse mund të bëj një koment të përgjithshëm, për sa i përket çështjes procedurale, dokumenteve të dosjes, kjo është një nga dosjet që ne kemi parë me shumë kujdes për mbledhjen e sotme. Rezulton se hetimi është bërë i plotë dhe i thellë për të tërë elementët. Ka edhe një vlerësim nga ana e relatores që ne e vlerësojmë që është një gjë në të gjitha rastet pozitive. Mendoj se, është një nga raste që edhe në kemi pasur shumë diskutim brenda për brenda institucionit. Për hir të së vërtetës, Institucioni i Presidentit të Republikës nuk është një institucion politik partiak. Në

kuptimin apo interpretimin e përjashtimit të përcaktuar në nenin 199 ajo ka të bëjë me pavarësinë e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Pavarësi e cila duhet të ishte një pavarësi e garantuar nga funksionet politike dhe në këtë kuptim mendoj së është i përcaktuar edhe parashikimi i mosmbajtjes së funksioneve politike në administratën publike. Kemi verifikuar qëndrimet çdo të thotë pozicion politik në administratën publike. Është e vërtetë që për herë të parë, ligji për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve ka bërë një përjashtim të qartë për anëtarët e organeve të Vetëqeveritjes, duke përjashtuar e konsideruar si funksionar politik dhe duke përjashtuar edhe këshilltarët e Presidentit të Republikës. Por këto janë dy ligje të ndryshme dhe kriteret mund të jenë të ndryshme. Mundet që edhe në këtë ligj të ishte përcaktuar në mënyrë të shprehur përjashtimi i këshilltarëve vetëm në pjesën e administratës publike, por edhe në pjesën e institucioneve të pavarura. Debati nëse institucionet e pavarura janë pjesë e administratës publike apo jo, edhe kjo është një çështje teorike e cila ka një diskutim shumë të gjerë dhe ka autor të ndryshëm që e trajtojnë çështjen në mënyra të ndryshme. Kjo edhe për shkak se në disa vende Presidenti i Republikës është organ i zgjedhur dhe në disa është organ i emëruar, si tek ne.

Unë i qëndroj mendimit së Institucioni i Republikës është institucion i pavarur. Nuk është institucion politik partiak dhe se termi funksion politik në ligjin për shërbimin civil, i cili në fakt e përcakton si funksionar politik edhe këshilltarët e institucionit të Presidentit të Republikës, i referohet mungesës së disa garancive për këta këshilltarë dhe jo sepse duhet të bëjë një politikë të caktuar partiake. Në gjykimin tim fakti që këto persona përfshihen dhe quhen funksionar politik, ka të bëjë me faktin që shkojnë dhe vijnë së bashku me titullarin e institucionit dhe nuk janë pjesë e ligjit të shërbimit civil, duke konsideruar se asnjë titullar nuk mund të lidhet dosmosdosmërisht me këshilltarët të cilët kanë qenë edhe më parë. Dhe në fakt dhe në rastin konkret, po ta shikojmë, është e qartë se sa herë është larguar njëri nga Presidentët janë dhënë dorëheqjet nga anëtarët e kabinetit dhe është rizgjedhur. Pra, kemi 3 emërime, nga 3 persona të ndryshëm që kanë konsideruar që disa nga anëtarët e kabinetit do të vazhdojnë të qëndrojnë në detyre edhe me ndryshimin e Presidentëve me vullnetin e tyre. Ka qenë me 3 Presidentë të Republikës. edhe termi i kabinetit nuk është dhënë në kuptimin e nocionit të qenies partiak, por ka të bëjë në gjykimin tim me faktin që shkojnë së bashku me titullarin. Për një periudhë kohe të caktuar edhe sekretarët e përgjithshëm kanë qenë funksionar politik, por tani nuk janë më funksionar politik, konsiderohen si pjesë e shërbimit civil dhe vazhdojnë të qëndrojnë në institucione edhe nëse ikën titullari i institucionit. Presidenti i Republikës ka dhënë qëndrimin që është funksion politik duke referuar ligjin e kohës. Por unë e gjykoj që nuk përbën një funksion politik, edhe për faktin që ka shërbyer

pranë Presidentëve të Republikës për tre mandateve me radhë. Ndërsa për sa i përket dokumenteve, nëse do të lejohet të kandidojë duhet thelluar edhe njëherë verifikimi nëse duhet kërkuar informacioni sipas nenit 199/ë, pavarësisht se e njoh faktin që Këshilli e ka kërkuar duke i dërguar shkresën organeve përkatëse.

Ardian Dvorani pasi evidenton që këto ishin kandidaturat për shqyrtim, sjell në vëmendje nevojën e bisedimit në Këshill se çfarë do të bëjmë me atë që u evidentua sot, në rastin e përgjigjeve që ka ardhur nga DSIK-ja, për sa i përket kushtit specifik të kandidimit për Inspektor të Lartë të Drejtësisë. Nëse, do të konkludojmë që duhet bërë diçka tjetër atëherë nuk mund të kemi vendim, do të shtyjmë vendimmarrjen për të marrë dokumentin, përgatisim një shkresë dhe e dërgojmë urgjentisht.

Erinda Balanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave, në lidhje me rastin e trajtuar më parë gjatë mbledhjes për kandidatin Rexhep Beteshi, merr fjalën dhe parashtron që mu vunë në dispozicion 2 dokumente që kanë të bëjnë si me qëndrimin e zotit Bektoshi, ashtu edhe me vendimin e dërguar nga autoriteti për informimit mbi dokumentet e sigurimit të shtetit. Rezulton se personi ka kryer funksione si hetues në dosje hetimore në çështje penale të cilat kanë të bëjnë më agjitacion dhe propagandë armiqësore kundër shtetit dhe përfshihet fushën e veprimit të ligjit për të drejtën e informimit për dokumentet e sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Në lidhje me këtë çështje, si Avokatit i Popullit ndajmë mendimin që për sa kohë ka informacione të tilla atëherë kjo përbën shkak për ndërprerjen e procedurës dhe ndalimin e kandidimit. Në Gjykatën Kushtetuese standardi i integritetit moral dhe profesional është shumë më i lartë sesa në organet e tjera dhe në këtë kuadër mendojmë se do të duhet që të mbahet parasysh një gjë e tillë. Ky është një standard i mbajtur nga institucioni jonë në vijimësi që prej të paktën 3 viteve të fundit të funksionimit të tij.

Së fundi, nuk kam më diskutim për rastin e kandidatës Eris Hysi. Mendoj se do të duhet të merret ekspert, këtë mund ta sjell edhe me shkrim.

Margarita Buhali shpjegon se për sa i përket shtyrjes së vendimmarrjes javën e kaluar për kandidaten Eris Hysi, duke pas-tur në konsideratë faktin që prej saj ishin dhënë dhe sqarime shtesë dhe se shtyrja u bë edhe për shkak të qëndrimit që mbajti Avokati i Popullit se nuk ishte njohur në detaje mbi pretendimet e saj shtesë. Kjo candidate ka sjellë edhe disa opinione të tjera në vlerësimin e saj të cilat janë dorëzuar të paktën sot në mëngjes ku pretendohet të argumentohet lidhur me mënyrën se si duhet të trajtohet shoqëria e thjeshtë, si një kooperim i personave fizik që përbën sipas saj një përjashtim nga ligji për tatimin mbi

të ardhurat personale. Ka vënë në dispozicion edhe një raport por pjesërisht të Drejtorisë së Tatimeve që i përket vitit 2015. Ka edhe një mendim të një eksperti audit dhe sipas opinionit të saj nuk përfshihet në personat që duhet të paguajnë tatimin mbi të ardhurat personale për sa i përket fitimit që ajo merr si ortake e kësaj shoqërie të thjeshtë. Ka pretenduar edhe caktimin e një eksperti në vlerësimin e saj, megjithatë këto ishin raportet shtesë të kësaj kandidate meqenëse kemi shtyrë shpalljen e vendimit.

Erinda Balanca merr fjalën dhe shprehet se e kemi studiuar çështjen e zonjës Eris Hysi dhe në fakt kjo lloj formë e shoqërisë të thjeshtë është një nga format me të cilën funksionojnë zyrat avokatore, jo vetëm në Shqipëri por edhe nëpër botë. Janë disa nga zyrat më të rëndësishme avokatore në Shqipëri që ushtrojnë dhe kanë zgjedhur të kenë këtë lloj formati të organizimit të tyre. Tatimi mbi dividetit është i përcaktuar qartësisht në ligj. Edhe tatimet të ardhurat e tatueshme. Nëse ka detyrim për të paguar një tatim shtesë mbi një të ardhur apo jo, apo një tatim mbi të ardhurat këtë duhet të përcaktojë ligji. Mënyra që ata kanë zgjedhur është një mënyrë në bazë të të cilave ata në përfundim marrin shumë të ardhura, por nuk është një punë e paligjshme. Në gjykimin tim sa e njoh unë këtë ligj dhe këtë funksionim edhe nga puna e mëparshme që kam bërë, janë edhe disa aktivitete të tjera, të cilat krijojnë pikërisht këtë lloj forme për të ushtruar aktivitetin e tyre dhe për të gjetur mënyrën më të mirë për të maksimalizuar fitimet e tyre gjithmonë në mënyrë të ligjshme dhe jo në mënyrë të paligjshme. Gjithsesi në rastin konkret mendoj se duhet të ishte vendim për caktimin e një eksperti fiskalist për të parë nëse ka apo jo detyrim për të paguar tatim tjetër përveç atyre që janë paguar në rastin. Për më tepër, për këtë studio avokatie ku zonja ka një pjesë të aksioneve, nuk është gjetur ndonjë problem nga kontrolli tatimor. Pastaj në lidhje me problematikat e tjera, nëse i ka deklaruar apo nuk i ka deklaruar këto të ardhura, kjo është një çështje tjetër dhe besoj se do të ishte e udhës që të merrej një ekspert. Fitimi që ajo ka marrë nga shoqëria me fitimin që ajo ka deklaruar tek të ardhurat të tjera bruto përputhen.. Pastaj është çështje debati ligjor.

Erinda Balanca merr fjalën dhe pyet nëse kjo kandidate e bërë deklarin për këtë vit?

Margarita Buhali shpjegon se kandidatja e ka bërë deklarin në Prill por janë marrë në KED më vonë, sepse inspektorati i ka shkresat më vonë, që janë dorëzuar dhe janë verifikuar. Për vitin kishte dhe një problem tjetër që u gjend nga ne që ajo kishte marrë në llogarinë e saj 45 mijë euro për 2018, ndërkohë nga shoqëria sipas bilanceve nuk referoheshin shpërndarje ishte një shumë. Subjekti ka të pa shpërndara sipas bilanceve të 2018, 36 milion dhe thotë për vitin 2018 vendimet, nuk ka vendime për shpërndarje.

Fatri Islamaj merr fjalën dhe pyet nëse nga institucionet fiskale është konstatuar që kjo kandidate për këtë periudhë për të cilën ne po diskutojmë 2014-2015 ose nga 2015 të jetë, të ketë cenuar ndonjë prej parashikimeve të ligjit për të ardhurat dhe të jetë konstatuar si e metë apo të jetë vënë ndonjë sanksion lidhur me këtë, nga vetë institucionet fiskale, si është konsideruar kandidatja.

Margarita Buhali shpjegon se vetë kandidatja nuk ka deklaruar të ardhura për këto vite. Nuk ka deklaruar për këto vite. Ajo nuk i ka deklaruar të ardhurat. Për ato që ka deklaruar, janë bërë llogaritjet dhe janë tatuar dhe për ato.

Fatri Islamaj merr fjalën dhe pyet nëse janë deklaruar si shoqëri po jo si person?

Margarita Buhali shpjegon se ka deklaruar si person. Ajo nuk i ka deklaruar institucionit kompetent që unë kam marrë këto të ardhura nga shoqëria. Prandaj nuk ka konstatime nga Drejtoria e Tatimit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pasi evidenton që këto ishin çështjet e programuara për shqyrtim në rendin e ditës dhe deklaroi mbylljen e mbledhjes.

MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 18.22

Sekretare

Dorina Dulaj

Redjona Myrtja

Ermelinda Kadiu

Kryetari

Ardian Dvorani